

Provokon Erdoğan/ Shkon vetë te Shën Sofia, e cila u kthye në xhami



Në një kohë kur pak ditë më parë, Këshilli Botëror i Kishave i bëri thirrje Recep Tayyip Erdoğan-it të tërhiqte mbrapsht vendimin e kthimit të muzeut të famshëm Shën Sofia në xhami, Presidenti i Turqisë e ka vizituar personalisht ndërtesën e shumëpërfolur.

Shën Sofia pritet të hapet për faljen e namazit pas 86 vitesh. Erdoğan qëndroi në Xhaminë Ajasofja rreth një orë, ndërsa u informua rreth punimeve të kryera për hapjen nga ministri i Kulturës dhe Turizmit, Mehmet Nuri Ersoy dhe guvernatori i Stambollit, Ali Yerlikaya.

Në një letër drejtuar presidentit turk, Këshilli që numëron 350 kisha anëtare, tha se një lëvizje e tillë është e destinuar të mbjellë përçarje.

Vendi i Trashëgimisë Botërore Unesco në Stamboll ka qenë një muze që nga viti 1934. Presidenti njoftoi vendimin e tij të premtën, pas një vendimi gjyqësor që

anuloi statusin e tij muze.

Shën Sofia ishte ndërtuar 1.500 vjet më parë si një katedrale e krishterë ortodokse, por u shndërrua në një xhami pas pushtimit otoman në 1453. U shndërrua në një muze me urdhër të Mustafa Kemal Atatürk, babai themelues i Turqisë moderne, laike. Që atëherë shërbimet fetare janë ndaluar në këtë zonë, por myslimanët e devotshëm kanë bërë fushatë të gjatë që adhurimi të lejohet.

— top-channel.tv